



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

i mbledhjes së parë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 26.1.2024, duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Pëllumb Bajçinovci, kryesues i komitetit, anëtarët e komitetit: Milazim Vitija, Jeta Rafuna, Donjeta Dragusha, Arbnora Berisha, Gëzim Sveçla, Nora Kelmendi dhe Mirsad Vitia.

Munguan: Shegë Beqiri, Leutrim Retkoceri dhe Bahri Gashi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Alban Zogaj - nënkyetar i Kryeqytetit, Osman Bllaca, përfaqësuesit e Drejtorisë së Pronës, Fidan Thaqi dhe Adnan Berisha, Izet Sadiku – drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Adelinë Sahiti – drejtore e Mirëqenies Sociale dhe Florim Krasniqi- përfaqësues i Drejtorisë së Urbanizmit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Pëllumb Bajçinovci - kryesues i komitetit, me këtë:

REND DITE

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së jashtëzakonshme dhe mbledhjes së dhjetë të Komitetit për Politikë e Financa;
2. Raporti i punës së Kryetarit të Kryeqytetit për vitin 2023;
3. Plani vjetor i punës i Kuvendit për vitin 2024;
4. Propozim-vendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm “Zona ekonomike” në Prishtinë;
5. Propozim-vendimi për nismën e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar;
6. Propozim-vendimi për marrëveshje – kornizë të bashkëpunimit ndërkombunal shumëfunksional ndërmjet: Kryeqytetit të Republikës së Kosovës – Prishtinës, Komunës së Podujevës, Komunës së Lipjanit, Komunës së Fushë Kosovës, Komunës së Graçanicës dhe Komunës së Obiliqit;
7. Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Gafurr (Ismail) Gosalcit, Gazmend (Sylejman) Gosalcit, Shemsi (Hamit) Gashit, Hasan (Brahim) Sylës, Vahide (Hasim) Xhumshshit dhe BTP Holding Sh.p.k;
8. Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Ruzhdi (Maliq) Ejupit;

Faqe 1 nga 7

9. Propozim–vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Faik (Arif) Rafunës;
10. Propozim–vendimi lidhur me Planin lokal të veprimit për cilësinë e ajrit në Komunën e Prishtinës 2023-2027;
11. Propozim–vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për dy familje strehuese Sinani dhe Selmani;
12. Propozim–vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e strehimores “Shpresa dhe shtëpitë e fëmijëve” - SDSF, e cila strehon fëmijët e braktisur, të abuzuar, të keqtrajtuar dhe raste tjera;
13. Të ndryshme.

Para se të fillonin me diskutimet për pikat e rendit të ditës, Izet Sadiku propozoi që të hyjë në rend dite **Propozim–vendimi për vënien në diskutim publik lidhur me Projektrregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së organizatave të biznesit në Komunën e Prishtinës, 01, nr.110-1203 e dt.16.6.2010.**

Gëzim Sveçla:- tha sa i përket pikës së dytë nuk e kemi si material.

Kryesuesi:- tha sa i përket këtij materiali nuk është se është kërkuar një material ma i detajuar se ka të bëjë me Raportin e punës së kryetarit të Kryeqytetit Përparim Rama për vitin 2023 është vonuar për shkak se kanë punuar edhe në pjesën grafike dhe pjesën tjeter, kryetari do ta prezantojë në seancë.

Gëzim Sveçla:- tha shumë e qartë është se materiali duhet të dërgohet 7 ditë para seancës, qysh me ardhur asamblistët në seancë pa pasur një material, çka kanë me diskutuar pa material.

Alban Zogaj:- në aspektin ligjor ki të drejtë plotësisht, raporti kryetarit është gati, kryetari e prezanton në seancë, ne mundem me ju dërguar sot materialin menjëherë pas seancës se është i gatshëm nëse jeni të pajtimit ju sot ju dërgojmë dhe kryetari e prezanton nëse nuk jeni të pajtimit e lëmë për seancën e shkurtit.

Gëzim Sveçla: - tha është e përcaktuar shumë mirë se kryetari raporton në mbledhjen e parë pas vitit të ri, është obligim ligjor kryetari me reportuar, është obligim ligjor që zyra e kuvendit me dërguar materialin 7 ditë para seancës.

Kryesuesi: - tha pasi takimi i radhës është me 31 janar keni mundësi me shfletuar me pa dhe me diskutuar në mbledhjen e radhës, u përmend aspekti ligjor dhe pjesa tjeter duhet filluar me ju përbajtur Rregullores dhe me qenë më mirë me kohë dhe ne si Kuvend dhe unë si kryesues do ta bëjë maksimumin.

Kryesuesi e paraqiti rendin e ditës me propozimin e Izet Sadikut që të futet në rend dite **Propozim–vendimi për vënien në diskutim publik lidhur me Projektrregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së organizatave të biznesit në Komunën e Prishtinës, 01, nr.110-1203 e dt.16.6.2010.**

Kryesuesi konstatoi se u miratua rendi i ri, me ndryshimin e bërë, me shtimin e një pike të re në rend të ditës.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit i mbledhjes së jashtëzakonshme dhe mbledhjes së dhjetë të Komitetit për Politikë e Financa.

Kryesuesi konstatoi se u miratua ekstrakti i procesverbalit i mbledhjes së jashtëzakonshme dhe mbledhjes së dhjetë të Komitetit për Politikë e Financa.

Pika e dytë

Raporti i punës së Kryetarit të Kryeqytetit për vitin 2023.

Alban Zogaj:- dha sqarime se është përgatitur raporti i punës së kryetarit të Kryeqytetit për vitin 2023, prezantohet në seancë, paraqet të gjitha të arriturat e vitit 2023 dhe sfidat normalisht gjithashtu prezanton edhe një plan për vitin 2024, materialin ju dërgojmë brenda ditës.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah **Raporti i punës i Kryetarit të Kryeqytetit për vitin 2023** dhe dërgohet në Kuvend për diskutim.

Pika e tretë

Plani vjetor i punës i Kuvendit për vitin 2024

Osman Bllaca: - dha sqarime lidhur me Planin vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2024, ku kemi tani ndryshim se në planin e punës përmuan janar hyn edhe kjo pika të cilën e propozoi sot Izet Sadiku. Po ashtu edhe te muaji qershor nuk është Ndërmarrja "Hortikultura", por "Ndërmarrja Publike Banesore" se është bërë këtu një lëshim, po ashtu përmuan Ndërmarrjen "Hortikultura" është marrë një vendim që të jetë "Ndërmarrja e gjelbër".

Kryesuesi konstatoi se u përkrah **Plani vjetor i punës së Kuvendit për vitin 2024** dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e katërt

Propozim-vendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm "Zona ekonomike" në Prishtinë

Florim Krasniqi: - tha se ideja e inicimit të këtij Planit rregullues apo hartimi i revidimit të këtij plani është me kërkesën e kryetarit dhe kërkesave të qytetarëve të vazhdueshme ndër vite. Ky plan fillimisht është miratuar në vitin 2012, kur është miratuar ky plan u miratua me parametrat, kriteret të cilat i ka pasur në atë kohë, në vitin 2014 për shkak të ndryshimeve ligjore, hyn në fuqi e mbizotëron Planin rregullues, PZHU, në atë kohë Ministria në nivel të komunave jep një interpretim përmes tē cilin thotë: ku ka mospërputhje ndërmjet Planit rregullues dhe Planit zhvillimor e mbizotëron PZHU-ja, në këtë rast penalizohen banorët se me Planin rregullues koeficienti ka qenë 2.4, PZHU-ja e ul në 100% në 1.2. Përveç këtij problemi është edhe problemi tjetër është një mbi infrastrukturë e cila edhe sot ka ndryshuar siç është rasti i unazës së brendshme që ka ndryshuar traseja e saj, ndërsa traseja e vjetër e shpërthen këtë plan përmes dhe ideja tjetër është në atë pjesë të zgjerohet kufiri i këtij plani dhe të akomodohet Kampusi sportiv siç është edhe i sqaruar në arsyetim. Kufiri i planit aktual e ka një sipërfaqe prej 576 ha po kërkohet edhe përmirësuar në 120 ha me u rrit në veri të këtij kufiri. Ideja është në këtë pjesën e propozuar përmirësuar përmirësuar gjendja reale e këtij plani në bazë të nevojave të banorëve që i kanë në atë pjesë.

Gëzim Sveçla:- tha janë disa arsyetime që po na sillen, është hera e tretë që ky plan po vjen dhe secili arsyetim ka qenë i ndryshëm, andaj po parashtroni këto pyetje, e para - cili është qëndrimi i vërtetë se tri arsyetime të ndryshme na kanë ardhur, e dyta - ku po i inkorporon kërkesat e banorëve në një hapësirë që pretendon me qenë Zonë ekonomike dhe Kampusi sportiv, apo flasim përmirësuar qendra komerciale apo përmirësuar objekte banimi.

Florim Krasniqi: - dha sqarime lidhur me pyetjet e parashtruara nga parafolësi.

Gëzim Sveçla: - tha ju cekët se ka prona private në atë zonë që po do me rritë, çka do të bëhet me këta pronarë, po ashtu pyeti cilat janë variantat që i përdor Komuna e Prishtinës përvèç këmbimeve të pronave.

Florim Krasniqi: - tha fatkeqësisht deri sot nuk janë shfrytëzuar mundësitet ligjore, të cilat i kemi në dispozicion.

Gëzim Sveçla: - pyeti a ka kod buxhetor përmirësuar qendra komerciale Komuna e Prishtinës.

Florim Krasniqi: - u përgjigj se nuk ka informacion përmirësuar përmirësuar qendra komerciale Komuna e Prishtinës diku, por ka diçka tjetër janë bonuset e zonimeve, me bonusë të zonimeve Komunës së Prishtinës dhe komunave tjera i jepet një mundësi e artë.

Gëzim Sveçla: - pyeti a janë implementuar dikund këto bonuset e zonimeve.

Florim Krasniqi: - tha jo, por jemi duke e implementuar në bazë të Udhëzimit administrativ përmirësuar përmirësuar qendra komerciale Komuna e Prishtinës dhe Hartë Zonale na e kemi obligim me hartuar një rregullore përmirësuar qendra komerciale, atë rregullore sigurisht ne si Kryeqytet nuk kemi me bërë një rregullore siç e kishte bërë Podujeva më herët jo në këtë qeverisje.

Gëzim Sveçla: - tha e kemi pasur një plan të ngjashëm Lakërishtën, cili ka qenë opinioni i MAPL-së, opinioni ligjor.

Florim Krasniqi: - dha sqarime lidhur me pyetjen e parashtruar nga parafolësi.

Gëzim Sveçla: -pyeti a ka mundësi ky Plan njësoj siç është kthyer përgjigja për Emshirin – Kalabrinë me pas përgjigjen e njëjtë në mungesë të dokumenteve, hartave zonale, PZHK.

Florim Krasniqi: - tha ka mundësi.

Gëzim Sveçla: - tha pse nuk po fokusoheni me kryer atë plan që po e kërkon ministria dhe me e shtyrë përpara.

Florim Krasniqi: - dha sqarime lidhur me çështjen e parashtruar nga parafolësi.

Alban Zogaj: - tha këtu e kemi një kërkësë të ekzekutivit dhe të kryetarit me hedh këtë zonë në revidim të Planit rregullues dhe detajet kur fillon me u reviduar plani dhe kur fillojmë me i diskutuar i diskutojmë këto detaje. Tani kërkesa është ta rregullojmë një zonë cila është e parregulluar aktualisht ose ka probleme në rregullimin aktual.

Florim Krasniqi: - dha sqarime plotësuese lidhur me këtë Propozim-vendim për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm “Zona ekonomike”.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah **Propozim-vendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm “Zona ekonomike”** në Prishtinë dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e pestë

Propozim- vendimi për nismën e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar

Kryesuesi: - tha sa i përket kësaj pike kemi të bëjmë me nismën e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar, kjo është nisma që ka të bëjë me nismën në mes të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, Prishtina dhe Kaohsiung City, Republika e Kinës (Taiwan).

Gëzim Sveçla: - pyeti se a ka kontaktuar dikush lidhur me këtë pikë.

Kryesuesi: - u përgjigj se mua personalisht jo, për të tjerët nuk e di.

Alban Zogaj: - tha nuk kom informata, kush e ka sjell këtë pikë është dashur me qenë këtu e me arsyetuar pikën.

Mirsad Vitija: - tha ne jemi dakorduar për këtë çështje që me ardhur personat kompetentë kur të sjellin pikën, ju kryesues duhet me kërkuar që anëtarët e komitetit po kërkojnë që pikat që vinë me pas përfaqësuesin që me arsyetuar përndryshe mos na i dërgoni hiç, as mos e thirrni KPF-në, besoj është më e rrugës.

Gëzim Sveçla: - propozoi që të tërhiqet pika e pestë e rendit të ditës **Propozim-vendimi për nismën e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar**, pasi që nuk kemi përfaqësues që të na jap sqarime lidhur me këtë pikë.

Kryesuesi konstatoi se me propozimin e anëtarëve të komitetit tërhiqet pika e pestë e rendit të ditës **Propozim-vendimi për nismën e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar**.

Pika e gjashtë

Propozim-vendimi për marrëveshje – kornizë të bashkëpunimit ndërkombunal shumëfunksional ndërmjet: Kryeqytetit të Republikës së Kosovës –Prishtinës, Komunës së Podujevës, Komunës së Lipjanit, Komunës së Fushë Kosovës, Komunës së Graçanicës dhe Komunës së Obiliqit.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah **Propozim-vendimi për marrëveshje – kornizë të bashkëpunimit ndërkombunal shumëfunksional ndërmjet: Kryeqytetit të Republikës së Kosovës – Prishtinës, Komunës së Podujevës, Komunës së Lipjanit, Komunës së Fushë Kosovës, Komunës së Graçanicës dhe Komunës së Obiliqit** dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e shtatë

Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Gafurr (Ismail) Gosalcit, Gazmend (Sylejman) Gosalcit, Shemsi (Hamil) Gashit, Hasan (Brahim) Sylës, Vahide (Hasim) Xhumshitit dhe BTP Holding Sh.p.k

Adnan Berisha: - përfaqësues i Drejtorisë së Pronës dha sqarime në pikë të shkurtra lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Nora Kelmendi: - pyeti pse tri këmbime që i kemi larguar herën e kaluar në muajin dhjetor në KPF nuk na kanë ardhur tash dhe kemi thënë me ardhur në muajin janar. Po ashtu tha se i ka disa pyetje e dini në bazë të legjislacionit në fuqi i tregoni kryetarit dhe Dorëntinës së Kuvendin Komunal më së pari duhet me sjell vendimin për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të ngastrës e cila ka m'u këmbyer personave privat në mënyrë që të realizohet këmbimi. Në atë Vendim duhet me kërkuar edhe vlerësimin e njësive kadastrale që janë objekt i këmbimit nga Ministria e Financave dhe Departamenti i tatimit në pronë, kështu janë rregullat kështu e thotë ligji, tash e tutje kështu kemi me punuar, kjo vlen edhe për pikën shtatë – tetë dhe nëntë.

Adnan Berisha: - dha sqarime lidhur me çështjet e cekura nga parafolësja.

Nora Kelmendi: - tha nëse vjen kështu materiali në Kuvend ne kemi me kthyer mbrapsht, po flas në bazë të ligjit. Vlen edhe për pikën shtatë – tetë dhe nëntë.

Adnan Berisha: - tha nëse është ligjore e respektojmë këtë që po kërkon.

Nora Kelmendi: - tha gjithmonë ka qenë ligjore, gjithmonë e kam kërkuar, e kërkon rregullorja, e kërkon ligji, këtu i kam kushtet për këmbimin e pronës së paluajtshme në kërkësë të komunës, e ke kapitullin këmbimi i pronës së paluajtshme, secilën pikë e ke, asnjëherë nuk është bërë vlerësimi në fund, ju thoni e kemi një rekomandim prej Ministrisë së Financave që vlerësimi duhet me u bë në fund. Kështu që për pikën e shtatë sot brenda ditës duhet me na dërguar vendimin.

Gëzim Sveçla: - tha qëllimi i diskutimit tonë këtu është që kjo lëndë me qenë ligjërisht në rregull dhe me kaluar ligjshmërinë. Ne asnjë këmbim që është në rregull ne nuk e kundërshtojmë, asnjë këmbim që ka interes publik nuk e kundërshtojmë, por jo me shkel ligjin për interesa të dikujt personale dhe financiare.

Nora Kelmendi: - tha vendimin duhet me sjell kryetari, një vendim të ri me na dërguar sot përmes emailit me këto pikë që i cekëm, nuk mundet m'u realizuar këmbimi nëse nuk e sjell vendimin e ri për interes të përgjithshëm publik dhe për vlerësim, ligji e thotë.

Kryesuesi konstataoi se u përkrah **Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Gafurr (Ismail) Gosalcit, Gazmend (Sylejman) Gosalcit, Shemsi (Hamit) Gashit, Hasan (Brahim) Sylës, Vahide (Hasim) Xhumshitit dhe BTP Holding Sh.p.k** dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e tetë

Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Ruzhdi (Maliq) Ejupit.

Adnan Berisha: - dha sqarime në pikë të shkurta lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Nora Kelmendi: - tha edhe pika e tetë është njëjtë si pikë shatë, por vendimi ndryshon, duhet me sjell vendimin për shpallje në interes publik dhe vlerësimin. Ekzekutivi sot duhet me na dërguar mendimin profesional SHNA që është bërë nga MMPI sa i përket pronave SHP Ujërat, kështu që e sillni sot brenda ditës mendimin profesional që të informohen gjithë asamblistët se kush menaxhon me SHP Ujërat dhe pronat e kujt janë SHP Ujërat.

Kryesuesi konstataoi se u përkrah **Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Ruzhdi (Maliq) Ejupit** dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e nëntë

Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Faik (Arif) Rafuna.

Adnan Berisha: - dha sqarime në pikë të shkurta lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah **Propozim-vendimi për Propozim–vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Faik (Arif) Rafunës** dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e dhjetë

Propozim–vendimi lidhur me Planin lokal të veprimit për cilësinë e ajrit në Komunën e Prishtinës 2023-2027

Kryesuesi tha se kjo Rregullore duhet t'i kalojë disa ndryshime të vogla, të cilat i kanë bërë dhe duhet m'u votuar me ndryshimet në seancë.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah **Propozim-vendimi lidhur me Planin lokal të veprimit për cilësinë e ajrit në Komunën e Prishtinës 2023-2027** dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e njëmbëdhjetë

Propozim–vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për dy familje strehuese Sinani dhe Selmani

Lidhur me këtë pikë në pika të shkurta na informoi **Adelinë Sahiti**, drejtore, tha Komuna e Prishtinës i ka dy fëmijë që kanë kaluar moshën 18 vjeçare, të cilët deri në moshën 18 vjeçare Ministria e Financave i mbështet me shumën mujore prej 350 €, por prej momentit që e kanë moshën madhore ju shkëputet kjo mbështetje, ne i kemi dy persona që janë mbi moshën 18 vjeçare dhe duhet m'i mbështetur këto dy familje strehuese që në mënyrë që këta fëmijë mos të na mbesin në rrugë se janë me aftësi të kufizuara njëri me autizëm, tjetri i palëvizshëm kështu që kemi një propozim –vendim që këtyre dy familjeve t'i ndihmojmë me nga 5 mijë € për familjet strehuese në vit e për dy familjet 10 mijë € në vit.

Gëzim Sveçla: - pyeti se këta fëmijë a janë duke e shfrytëzuar një pension që është për personave me aftësi të kufizuara prej moshës 18 - 65 se ka shumë njerëz nuk e dinë këtë mundësi me shfrytëzuar.

Adelinë Sahiti: - tha po, janë duke e marrë pensionin invalidor.

Jeta Rafuna: - tha e uroj drejtoreshën për këtë vendim dhe ne si LDK e përkrahim këtë propozim-vendim.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah **Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për dy familje strehuese Sinani dhe Selmani** dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e dymbëdhjetë

Propozim–vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e strehimores “Shpresa dhe shtëpitë e fëmijëve”- SDSF, e cila strehon fëmijët e braktisur, të abuzuar, të keqtrajtuar dhe raste tjera

Adelina Sahiti: - dha sqarime lidhur me këtë pikë duke cekur se Drejtoria për Mirëqenie Sociale dhe Qendra për Punë Sociale ka bashkëpunim të ngushtë me Strehimoren e “Shpresa dhe shtëpitë e fëmijëve”, në të cilën referon të gjithë fëmijët/rastet e braktisjes, abuzimit dhe lloje të tjera të keqtrajtimit për vendosje rezidenciale në këtë institucion, duke marrë parasysh vështirësitë financiare që po kalon kjo strehimore dhe me qëllim për të siguruar shërbime cilësore dhe të qëndrueshme për këtë kategori të fëmijëve dhe strehimin e tyre. SDSF ka parashtruar kërkesën për mbështetje financiare. DMS parashtron kërkesën dhe propozimin për subvencionimin e SDSF në vlerë prej 17,500 € si urgjencë për plotësimin e kërkesave dhe nevojave për strehimin e fëmijëve dhe ofrimin e shërbimeve të duhura për ta.

Nora Kelmendi: - pyeti pse kërkesën e strehimores nuk e kemi në dokumente, ju e keni sjell vetëm kërkesën e juaj që e keni bërë.

Adelina Sahiti: - tha e kemi në email kërkesën se me email e kanë bërë kërkesën dhe brenda ditës ju dërgojmë.

Osman Bllaca: - tha ne jemi në draft të ndryshimit të Rregullores të subvacioneve dhe me paraparë që këtu shuma prej 5000 € mos të vijë në Kuvend, ju si ekzekutiv ta keni të drejtën që me ju dhënë vetë.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah **Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e strehimores “Shpresa dhe shtëpitë e fëmijëve”– SDSF, e cila strehon fëmijët e braktisur, të abuzuar, të keqtrajtuar dhe raste tjera, si dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

Pika e trembëdhjetë

Propozim-vendim për vënien në diskutim publik lidhur me Projektrregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së organizatave të biznesit në Komunën e Prishtinës, 01, nr.110-1203 e dt.16.6.2010.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah **Propozim-vendimi** për vënien në diskutim publik lidhur me **Projektrregulloren** për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së organizatave të biznesit në Komunën e Prishtinës, 01, nr.110-1203 e dt.16.6.2010 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Të ndryshme

Kryesuesi: - tha, me Planin vjetor të punës së Kuvendit të Kryeqytetit, éshtë hera e tretë që éshtë duke u vendosur për një vizitë studimore e cila ka të bëjë me anëtarët e Kuvendit, këshilltarë komunalë për me bërë një takim më të mirë të punës dhe nevojën për ndryshimin e Statut – Rregullore. Nëse jeni të pajtimit të organizojmë besoj për herën e tretë mundemi t’ia dalim këtë vit dhe ta krijojmë një grup më të madh dhe të marrim vendime më të mëdha dhe të njëjtën kohë ta shfrytëzojmë një vizitë jashtë qytetit.

Gëzim Sveçla: - pjesë e ekzekutivit éshtë për me i dhënë propozimet, të cilat ne pastaj i vlerësojmë nëse janë të arsyeshme dhe kanë me ndikuar në performancën edhe të Komitetit dhe Kuvendit me amandamentimet eventuale na nuk jemi kundër asaj gjëje. Po ashtu pyeti a ka koalicion në Prishtinë sepse ne po kemi problem për shumë çështje të caktuara, as nuk po dimë kujt me ju drejtuar drejtorive qe dy-tri seancave asnjë drejtor i PDK nuk vjen në seanca, janë çështje që janë në interes tonin, po na pyesin edhe qytetarët.

Kryesuesi: - tha muaji janar ka filluar me ato pushimet e gjata, drejtoritë janë duke funksionuar.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40 .

Procesmbajtësja
Shyrete Islami

Kryesues i Komitetit
Pëllumb Bajçinoveci

